



Planina / Ditezhoni Punëpunë / Prerada Rreze / Ditezhoni	20.01	2	viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Shërbimi Org / Unit	Dr. Prist Dr. Prist Prisht	Shërbimi Pririg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHCK	254/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1014/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1014/2021 të datës 07.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë Komuna e Prishtinë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1014/2021 e datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. DETYROHET** Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e vendimit nr:14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021, duke bërë kompensimin e pagës prej 50% prej datës 11.04.2014 deri në zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prishtinës që të bëjë korrigjimin e paragrafit 4 të arsyetimit të vendimit nr: 14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ndaj ankueses \_\_\_\_\_ a punësuar në pozitën “Inspektore e Ndërtimit” në Komunën e Prishtinës, Kryetari i Komunës së Prishtinës më datë 11.04.2014 ka nxjerr Vendim me numër 01.118-87652 me të cilin vendim ka bërë pezullimin parandalues të ankueses me 50% të pagesë deri në vendimin përfundimtar nga gjykata.

Gjykata e Apelit e Kosovës/Departamenti Special me datë 26.04.2021 merr Aktgjykimin me numër APS.nr.4/2021 me të cilin aktgjykim ankuesja lirohet nga aktakuza dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit Kryetari i Komunës së Prishtinës merr vendimin me numër 14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021 me të cilin vendim ankuesja kthehet në vendin e saj të punës “Inspektore e ndërtimit” në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit nga data 01.11.2021.

Ankuesja \_\_\_\_\_ e pa kënaqur me arsyetimin e Vendimit me numër 14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me datë 07.12.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 07.12.2021 ndërsa me datë 19.01.2022 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë bënë plotësimin e ankesës së datës 07.12.2021 i cili plotësim është protokolluar me numër 253/2022 të datës 20.01.2022 duke kërkuar që t'i njihet edhe kompensimi i pagesës së 50%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.12.2021 ankesën e ankueses e ka dërguar tek Komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë. Më datë 24.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjeje në ankesë nga Komuna e Prishtinës me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/5.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses së datës 07.12.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër 01-112-234 i datës 01.11.2021 e ankueses \_\_\_\_\_ Vendimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 27.10.2021; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës/Departamenti Special APS.Nr.4/2021 i datës 26.04.2021; Vendimi i datës 11.04.2014 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës si dhe përgjigjia në ankesë nga organi i punësmiit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses \_\_\_\_\_ është **bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses të parashtruar me ankesën e datës 07.12.2021 dhe të plotësimit të ankesës së datës 19.01.2022 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në ankesën e datës 07.12.2021 ka pretenduar se Vendimi i datës 27.10.2021 i marrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës në arsyetimin e dhënë gabimisht është konstatuar paragrafi katër (4) “kinse unë jam dënuar dhe kam paguar gjobën në lidhje me shqiptimin e

dënimit (citat: "...por me pëlqimin e të akuzuarit në fjalë është paguar dënimi me gjobë"), ndërka unë nuk jam dënuar me gjobë dhe as një formë tjetër, por jemi liruar nga aktakuza sipas vendimit të formës së prerë APS Nr.4/2021 të datës 26.04.2021 të Gjykatës së Apelit", dhe kërkon nga Këshilli që ta detyroj Komunën e Prishtinës respektivisht Sektorin e Burimeve Njerëzore që të bëjë korrigjimin e arsytimit të vendimit të lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses sipas ankesës së datës 07.12.2021 e cila pretendon se Kryetari i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së vendimit numër:14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021 për kthimin e ankueses në vendin e punës ka keqinterpretuar Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të Gjykatës Apelit të Kosovës -Departamenti Special të datës 26.04.2021, pasi që ne paragrafin 4 të arsytimit të vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 27.10.2021 potencohet: "Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda pasi që lënda është kthyer në rigjykim, të akuzuarën e ka gjykuar dhe e ka dënuar por me pëlqimin e të akuzuarës në fjalë është paguar dënimi me gjobë", Kolegji ka gjetur se në Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës -Departamenti Special të datës 26.04.2021 në faqe nëntëmbëdhjetë (19) nga rreshti tre (3) e tutje theksohet, citoj: "Të akuzuarën për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par. 1 të KPP-së me dënim më burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarës do t'i shndërrohet në dënim me gjobë....", andaj mbi bazën e kësaj të gjeture Kolegji konstaton se ankuesja nuk ka paguar dënim me gjobë pasi që Aktgjykimi në fjalë nuk është bërë i ekzekutueshëm me faktin që palët kundër këtij Aktgjykimi në afat ligjor kanë ushtruar ankesë, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar ngase Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti Special përmes Aktgjykimit APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021 ka vendosur përfundimisht lidhur me aktakuzën e ushtruar ndaj ankueses dhe të njëjtën e ka liruar nga të gjitha akuzat e ngritura ndaj saj.

Andaj, Kryetari i Komunës e Prishtinës obligohet të bëjë korrigjimin e aktit-respektivisht vendimit numër:14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021 dhe se duhet të jetë i kujdesshëm gjatë elaborimit të kronologjisë së rastit duke mos iu referuar gabimisht apo duke mos tjetërsuar të gjeturat dhe mënyrën e vendosjes në instancë gjyqësore, ndërsa në arsytim të vendimit të ndryshuar dhe korrigjuar duhet të mbetet vetëm konstatimi sipas Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës -Departamenti Special të datës 26.04.2021 ku theksohet fakti se ankuesja është liruar nga të gjitha aktakuzat e ngritura ndaj saj.

Kolegji për shqyrtimit dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses të plotësuar me ankesën e datës 19.01.2022 lidhur me kompensimin e pagës prej 50% të ardhurave personale të ndaluara sipas vendimit për pezullim të datës 11.04.2014 dhe Kolegji vlerëson se lidhur me pretendimin e lartcekur të ankueses Kryetari i Komunës së Prishtinës ka nxjerr vendimin numër:14-112/03-229797/21/21 të datës 27.10.2021 ku në dispozitivin e dytë (2) të këtij vendimi ankueses ju ka njoftuar e drejta e kompensimit të 50% të të ardhurave personale mirëpo mirë po Komuna e Prishtinës nuk e ka kompensuar ankuesen në shumën prej 50% sipas pikës II të dispozitivit të vendimit numër:14-112/03-229797/21 të datës 27.10.2021, andaj Komuna e Prishtinës është e

obliguar që ankueses t'ia bëjë kompensimin e pagës prej 50%, prej datës 11.04.2014 kur është nxjerr Vendimi me numër 01.nr.118-87652 për pezullim parandalues prej 50% të ankueses deri në zbatimin e këtij vendimi, duke ja kompensuar edhe tatimin në pagë dhe tatimin e trustit pensional.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda numër A.nr.1014/2021

**Valentina Kaçandolli Bekteshi**

*Kaçandolli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.